

Buletin informativ

Gusht 2020



Ekspertët fiskal në Mazars, sjellin pranë jush buletin informativ të rradhës si një përmbledhje e ndryshimeve dhe shtesave më të fundit ligjore të publikuara në vendin tonë.

❖ Shtyhet afati i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme

Të gjithë individët të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që deri në datën 31 dhjetor 2020 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Afati i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme përpara këtij ndryshim ishte data 30 shtator 2020. Për më shumë detaje mbi procesin e rivlerësimit, referohuni Buletinit Informativ Nr.2 të përgatitur nga Mazars.

Burimi: Për disa ndryshime në Ligjin Nr 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, Fletorja Zyrtare nr. 136.

❖ Shtyhet afati i raportimi të llogarive financiare në kuadër të shkëmbimit automatik të informacionit

Vetëm për raportimin e parë, procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet administratës tatimore dhe juridiksioneve të tjera kompetente do të kryhet brenda datës 31.12.2020. Për periudhat e tjera pasuese, shkëmbimi do të bëhet brenda 9-mujorit të parë të çdo viti.

Vetëm për raportimin e parë, institucioni financiar raportues pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019. Përpara këtij ndryshim, afati i raportimit ishte data 31 korrik 2020.

Buletin informativ

Burimi: *Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 4/2020, "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare", Fletorja Zyrtare nr. 146*

❖ Shtyhet procesi i zbatimit të fiskalizimit për transaksionet me para në dorë

Afati i aplikimit të procesit të fiskalizimit për transaksionet me para në dorë shtyhet për në shtator 2021.

Afati fillestar	Afati aktual
1 shtator 2020 - për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimit me të ardhura vjetore mbi 8 milionë lekë	Shtyhet në shtator 2021
1 janar 2021- për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit të thjeshtuar mbi ftimin me të ardhura vjetore mbi 2 milionë	Shtyhet në shtator 2021
1 janar 2021 - për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në 2 milionë lekë	Shtyhet në shtator 2021
1 janar 2021 - për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike	Mbetet në 1 janar 2021
1 korrik 2021- për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve	Mbetet në 1 korrik 2021

Burimi: *Për një ndryshim në Ligjin Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", Fletorja Zyrtare nr. 146*

❖ Ndryshon niveli minimal i regjistrimit për Tatimin mbi Vlerën e shtuar

Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH rritet në vlerën e qarkullimit prej 10,000,000 lekë në një vit kalendarik. Kufiri minimal i regjistrimit të TVSH-së është tashmë i aplikueshëm edhe në rastet e profesioneve të lirë. Përpara këtij ndryshimi, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH ishte 2,000,000 lekë, ndërkohë që profesionet e lira ishin subjekt i TVSH-së pavarësisht nivelit vjetor të qarkullimit.

Personi i tatueshëm ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin e TVSH-së, nëse qarkullimi vjetor është më i madh se 5,000,000 lekë.

Burimi: *Për disa ndryshime në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Fletorja Zyrtare nr. 139*

Buletin informativ

Të tjera

Është aprovuar nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar" i cili parashikon eliminim të normës së tatim fitimit për bizneset me të ardhura nën 14,000,000 lekë në vit.

Vendimi do të jetë efektiv pas botimit në fletoren zyrtare dhe pritët të shtrijë efektet duke filluar nga janari 2021.

Propozimi	Aktual
Shkalla e aplikueshme e tatim fitimit propozohet të jetë: 1) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit 2) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14,000,000 lekë në vit*	Shkalla e aplikueshme e tatim fitimit është: 1) 5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit. 2) 15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14,000,000 lekë në vit.

Buletin informativ

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në lëmin fiskal, ju lutem drejtohuni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889

E-mail: info@mazars.al